



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1010/9 Prot.

Tiranë, më 24.07.2020

V E N D I M

Nr. 29 datë 24.07 2020

**MBI MIRATIMIN E PAGESAVE TË STAFIT, PËR PËRFUNDIMIN E
PROCEDURAVE TË TESTIMIT PËR RIÇERTIFIKIMIN DHE KURSIN
PËR ÇERTIFIKIMIN E UDHËRRËFYESVE TURISTIK**

Në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Statutin UST, të VKM nr. 692 datë 05.10.2016 "Për miratimin e Rregullores për kriteret për pajisjen me çertifikatën për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë ...", në VKM Nr. 329 dt.12.04.2017, "Për statutin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", Udhëzimit nr.517 datë 24.01.2017" Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe i kreditimit të programeve për edukimin profesional në vazhdim", në shkresat e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit nr. 585/3 datë 28.02.2019, nr. 2620/1 datë 18.04.2019 "Mbi kërkesën për akreditimin programi" dhe Vendim të Senatit nr. 26 datë 17.05.2019 "Mbi miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të kursit profesional të çertifikimit të udhërrëfyesve të specialiteteve të veçantë", Vendimi BA nr. 22 datë 28.05.2019 "Mbi miratimin e tarifave", Vendimi nr. 34 datë 21.10.2019 "Mbi miratimin e tarifave të aplikimit dhe të regjistrimit, për kursin profesional për plotësimin e krediteve për çertifikimin e udhërrëfyesit turistik", shkresën FVFR nr. 902 datë 26.06.2020 "Informacion mbi realizimin e testimit të riçertifikimit si dhe të kursit të çertifikimit të udhërrëfyesit turistik të specialitetit të veçantë", Relacionin përkatës, Bordi i Administrimit ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën e stafit të angazhuar për përfundimin e procedurave të testimit për riçertifikimin dhe kursin për çertifikimin e udhërrëfyesit turistik, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Shpenzimet për pagesën e orëve mësimore dhe administrative mbulohen nga të ardhurat e krijuara nga pjesmarrja e aplikantëve .

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UST, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare www.ust.edu.al dhe tek portali i transparencës universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen Domi

